



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.4/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas Ankesës së iniciuar nga ana e Avokatit të Popullit për palën B. P., nga Dragashi kundër gjyqtarit G. Sh., , gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur, në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës dicitinore, me dt.21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar Ankesa e iniciuar nga ana e Avokatit të Popullit për palën B. P., nga Dragashi, kundër gjyqtarit G. Sh., , gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren për iniciimin e procedurës disiplinore

A r s y e t i m.

Parashtruesja e ankesës pala B. P., lindur Q., nga Dragashi me dt.22 prill 2024 është drejtuar Avokatit të Popullit me ankesë për iniciim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit G. Sh., lidhur me veprimet e gjyqtarit në çështjen e saj në kuptim të nenit 16 par. 1 të Ligjit nr. 05/L-19. Avokati i Popullit bazuar në kompetenca të veta të përcaktuara me nenin 9 par.3 dhe 5 të Ligjit 06/1-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka proceduar ankesën në Gjykatë Themelore në Prizren si gjykatë kompetente për trajtim ligjor.

Si Kryetare e gjykatës kam pranuar ankesën me dt. 26 prill 2024 dhe pasi që kam identifikuar çështjen kam iniciuar procedurën preliminare të hetimeve për procedure disiplinore dhe kam ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht kam bërë shqimin në ankesën e parashtruar nga ankuesja B. P., dhe kam bërë shqimin në dokumentacionin përcjellës të bashkangjitur në ankesë, kam kërkuar deklaratë nga gjyqtari G. Sh., kam bërë shqimin në shkresa të lëndës C.nr.5255/23 dhe pas analizës së të gjitha këtyre shkresave kam konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Ankuesja B. P., lindur Q., nga Dragashi ka cekur se është palë e paditur në procedurën civile për shkurorëzim të iniciuar nga ana e bashkëshortit të saj B P., dhe se lënda është tek gjyqtari G. Sh., , gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren . Ka cekur se gjyqtari ka bërë disa veprime të cilat i konsideron të padrejta dhe se ajo vetëm ka kërkuar që ti kompensohet shuma prej 2800€ e cila ka qenë dhuratë nga ana e nënës për martesë . Gjithashtu ka cekur se gjyqtari nuk e ka proceduar lëndën në mënyrë profesionale dhe se nuk i ka mare për bazë faktet të cilat i ka propozuar dhe të citat kanë dëshmuar dhunën nga ana e bashkëshortit të saj, nuk është informuar për mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike falas pasi që nuk ka kushte për angazhim të avokatit, është ngarkuar me shpenzime procedurale edhe pse ajo nuk ka iniciuar procedurën për shkurorëzim dhe në fund nuk është aprovuar kërkesa e saj për kompensim gjithashtu nuk është

udhëzuar që këtë të drejtë mund të kërkon në një procedurë të veçantë. Në bazë të gjitha këtyre konsideron se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore dhe se ka besim se institucionet përkatëse do të ndërmarrin veprime konkrete dhe do të ndërmarrin masa ligjore ndaj gjyqtarit.

Gjyqtari G. Sh., në deklaratën e tij ka cekur se duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me lëndë me prioritet ka vepruar sipas ligjit dhe pasi që e ka pranuar lëndën ka dërguar Aktvendim për përgjigje në padi ku e paditura ka parashtruar përgjigje. Më pas ka caktuar shqyrtimet gjyqësore sipas LPK —së. Sa I përket pretendimeve të ankueses se nuk nuk ka pasur të autorizuar kjo nuk qëndron pasi që të njejtën në shqyrtimin kryesor e ka përfaqësuar I autorizuari I saj Gazmend Korbi me autorizim të rregullt të noterizuar. Ankuesja dhe I autorizuari I saj kanë cekur se nuk kanë kërkuar asgjë më shumë se kompensim në shumë prej 2800€ për të pranuar zgjidhjen e martesës , por çështja është se të njejtë kanë qenë të njohtuar se kemi të bëjmë me kontestin për zgjidhje të martesës ku nuk mund të lëshohemi në çështjen e kompensimit të demit dhe kthimit të dhuratave , mirëpo këtë kërkesë e njejtë mund të realizohet në një procedure të veçantë kontestimore me padi për kthim të dhuratave Ose të pjestimit të pasurisë bashkëshortore. Ndërsa sa I përket çështjes se e njejtë nuk është njoftuar lidhur me të drejtën se mund të shfrytëzojë shërbimet e Zyres për ndihmë falas gjyqtari nuk ka pasur informatë se e njejtë është shfrytëzuese e Asistencës Sociale . Në lidhje me zgjidhjen e martesës dhe shpenzimeve procedurale gjyqtari ka cekur se ka vendosur sipas bindjes së lire dhe se palët në procedure kanë të drejtë në ankesë të cilën të drejtë e ka shfrytëzuar e paditura e Cila me dt. 29.03.2024 ka pranuar Aktgjykimin dhe ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit . Në fund të deklaratës së tij gjyqtari ka cekur se nuk ka shkelur Ligjtin për Procedurë disiplinore, I ka trajtuar në mënyrë të barabartë palët në procedure, lënda është me prioritet dhe nëse e paditura ka vërejtje në udhëheqjen e procedurës ka të drejtë në ankesë ndaj vendimit të gjyqtarit të cilën drejtë edhe e ka shfrytëzuar në bazë të ligjit.

Me shiqimin në shkresa të lëndës gjykata ka vërtetuar se paditësi Bari P., nga fsh. Vermicë, Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av. R P., nga Prizreni, me dt. 28.12.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës B. P., nga fshati Pllajnik Komuna e Dragashit, për zgjidhjen e martesës . Lënda e ka mar numrin C.nr.5255/23 dhe në mënyrë automatike I është ndarë gjyqtarit G. Sh., Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me lëndë e Cila sipas Strategjisë së KGJK —së është prioritare gjyqtari e ka caktuar dhe janë mbajtur dy seanca . Në seancën e parë pergatitore kanë prezantuar avokati R P., për paditësin, me autorizim dhe e paditura personalisht, në seancën e dytë kryesore kanë prezantuar për paditësin avokati R P., e paditura B. P., personalisht dhe I autorizuari I saj G.K., nga fshati Kolesian , Komuna e Kuksit, Republika e Shqipërisë me autorizim të vërtetuar tek Noteri A.M-M., , të cilin e ka dorëzuar gjykatës dhe e njejtë është bashkangjitur në shkresa të lëndës. Shqyrtimi është mbajtur sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe pas administrimit të provave palët janë deklaruar në fjalën përfundimtare të tyre ku edhe ka përfunduar shqyrtimi. Pas kësaj gjyqtari ka vendosur me Aktgjykim ku ka aprovuar kërkesën e paditësit dhe është zgjidhur martesë me shkurorëzim në mes të palëve dhe është obliguar e paditura të paguaj shpenzimet procedurale. Ndaj këtij Aktgjykimi me dt. 18.04.2024 ka parashtruar Ankesë e paditura B. P., dhe lënda pas shqyrtimit të kësaj ankesë disiplinore do të përcillet në Gjykatën e Apelit për vendosje sipas ankesës.

Në bazë të lartë cekurave gjykata ka konstatuar se gjyqtari ka proceduar lëndën bazuar në parimet e LPK-së duke e shqyrtuar padinë në suaza të kërkesëpadsisë dhe rregullave të procedurës. Ankuesja në rastin konkret ka pasur të autorizuar dhe është përfaqësuar në mënyrë të duhur në shqyrtimin kryesor dhe nuk ka cekur ndonjë kërkesë për shtyerje për shkak të angazhimit të avokatit , ose nuk ka cekur se është e gjendjes së dobët ekonomike , se pranon ndihmë sociale ose ndonjë shkak tjetër që do të rezultonte me udhëzimin në ndihmë juridike falas. Asnjë nga këto arsye nuk është konstatuar në procesverbale të mbajtura. Sa I përket udhëzimit se mund të realizojë kërkesën në një procedure të veçantë këtë do të duhej të udhëzonte I autorizuari I saj I cili e ka përfaqësuar në shqyrtimin kryesor , por të cilën drejtë nuk e ka humbur edhe tani dhe këtë mund të bëjë në çdo kohë me padi të veçantë. Gjykata konsideron se vërejtjet dhe ankesat e pales së paditur janë të natyrës procedural dhe se të njetat nuk e kanë natyrën e shkeljeve disiplinore të cilat parashihen me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe

Prokurorëve. Konsideroj se këto ankesa do të shqyrtohen nga ana e Gjykatës së Apelit sipas ankesës së rregullt të cilën e ka parashtruar e paditura, në rastin tone ankuesja B. P., lindur Q.,.

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore në rastin konkret, respektivisht nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nr. 06/1-067.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.4/24 me dt.21.05.2024

katës Themelore në Prizren
Shpresa Emra
e drejta e ankesës.



KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.